

Në bazë të nenit 147 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr.103 / 2008.33 / 1010, 116/2010, 156 / 2010,18 / 2011, 51/2011 dhe 06/2012.) komisioni për Vetëvlerësim i SHFK"Goce Dellçev" - Gostivar hartoi

RAPORT

Për kryerjen e VETËVLERËSIMIT të SHFK "Goce Dellçev"- Gostivar në vitin shkollor 2018/2019 me propozim masa për përmirësimin e mësimdhënies.

Në bazë të nenit 147 paragrafi 3 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr.103 / 2008. 33 / 1010, 116/2010, 156 / 2010.18 / 2011, 51/2011 dhe 06/2012) dhe vendimit të sjellur nga ana e këshillit drejtues më datë 19.11.2018 formoi komisionin shkollor për hartimin e raportit për vetëvlerësimin e kryer për vitin shkollor 2018/2019, me propozim masa për përmirësimin e punës së shkollës në vitet e ardhshme.

Komisioni është i përbërë nga:

1. Sahide Neziri – pedagoge
2. Gordana Nastovska – psikologe
3. Mirushe Xhaferi – mësimdhënës klasor
4. Goran Pavloski – arsimtar lëndor
5. Dragan Mateski– përfaqësues i prindërve

Duke filluar nga muaji dhjetor të vitit 2018 në Sh. F. K. "Goce Dellçev", Gostivar, filloj të implementohet Vetëvlerësimi për punën e shkollës për dy vitet e kaluara. Për implementimin e së njejtës formohen komisione për vetëvlerësim dhe grupet për vetëevaluim.

Subjekt i vetëvlerësimit janë shtatë fushat kryesore që kanë të bëjnë me aspektet kryesore të shkollës dhe çdo grup e përbëjnë dy coordinator dhe grup i veçantë i mësimdhënësve.

1.PLAN PROGRAMET MËSIMORE

-Kordinator i grupit: Angjellko Jankoski,Ardijana Ziberi

2. ARRITJET E NXËNËSVE

-Kordinator I grupit:Nagijan Snopçe, Branka Zmejkoska

3. . MËSIM DHE MËSIMDHËNIE

- Kordinator I grupit : Blagica Petrovska, Alpina F. Beshiri

4. MBËSHTETJA E NXËNËSVE

- Kordinator I grupit : Jeta Sadiku,Nikolina Karanfilloska

5.ETOS (klima e shkollës)

- Kordinator i grupit : Todorka Krajçeska, Valdeta Mislimi

6. RESURSE

-Kordinator I grupit : Munever Elmazi, Orce Millçeski

7. MENAXHIMI DHE KRIJIMI I POLITIKËS

- Kordinator I grupit : Aleksandra Ognjanoska, Lindita Ismaili

Në çdo fushë arsimtarët e grupit punojnë në treguesit paraprakisht të zhvilluar që masin cilësinë e punës së shkollës ku si burim i informacioneve shfrytëzohen intervista, pyetësorë, anketimet e nxënësve, prindërve, mësuesve, inspektimin e të dhënave të arsimit dhe të dokumentacionit, analiza e tyre e dokumenteve biseda.

Në çdo fushë të vetëvlerësimit realizohet analizë e lëmis, kryhen anët e forta dhe të dobta dhe pohojnë prioritete dhe aktivitete të ardhshme në bazë të së cilave bëhet zhvillimi i planit të shkollës. Në bazë të rezultateve të kryerjes së vetëvlerësimit janë fituar rezultate nga këto fusha.

1.PLAN PROGRAMET MËSIMORE

Komisioni konstatoi se shkolla planifikon dhe realizon më shumë lloje të mësimdhënies:

Aktivitetet obligative plotësuese, shtuese, aktivitete të lira të nxënësve etj. Aktivitetet jashtëmësimore. Plan programet mësimore janë në pajtueshmëri me MASH dhe BZHA dhe janë të dorëzuar në kohë.Arsimtarët gjatë planifikimit të mësimdhënies rregullisht bashkëpunojnë me shërbimin profesional. Shkolla shfrytëzon më shumë mënyra që t'i informon prindërit për punën që bën si dhe të njejtit i kyç në të. Shkolla ju mundëson pjesës më të madhe të nxënësve të kyçen në aktivitete jashtëmësimore edhe sipas dëshirës së tyre.

2. ARRITJET E NXËNËSVE

Komisioni konstatoi se shkolla në mënyrë permanente përcjell punën dhe arritjet e nxënësve pa marrë parasysh gjinisë dhe përkatësisë etnike si dhe statusit social të familjes. Arsimtarët i motivojnë nxënësit si dhe e stimulojnë punën e tyre,vetinicijative dhe kreative. Rezultatet për suksesin e arritur në Këshillin e arsimtarëve krahasohet me periodhat e mëparshme. Kriteriumi i notimit është objektiv dhe publik, ndërsa notat shkruhen në mënyrë transparente dhe shqaruese. Prindërit rregullisht dhe në kohë informohen për arritjet e nxënësve nepërmjet mbledhjeve prindore si dhe E- ditarit. Komisioni gjithashtu konstatoi se në shkollën tone nuk ka nxënës që nuk e mbarojnë vitin shkollor dhe se ka më pak nxënës.

3. MËSIMI DHE MËSIMDHËNIA

Arsimtarët përgatisin planifikime vjetore,tematike si dhe planet tematiko-procesuale në fillim të vitit shkollor,ku janë të përfshira qëllimet për intgrim ndëretnik. Rregullisht I shkruajnë përgatitjet ditore për orë në mënyrë elektronike apo të shkruar dhe për të njejtat konsultohen me shërbimin pedagogjik. Në planifikimet janë të përfshirë metoda dhe teknika të ndryshme për realizim të mësimit bashkëkohor,si dhe

instrumente nepërmjet të së cilëve bëhet vlerësimi formative dhe sumativ. Arsimitarët I planifikojnë të gjitha detyrat dhe aktivitetet që duhet të realizohen në shkollë apo në shtëpi,dhe të njejtat janë të përshtatura sipas nevojave të nxënësve që t'i arrijnë qëllimet e parapara të mësimi. Mënyra se si mësohet në shkollë është interesante dhe me inkurajimin nga ana e arsimtarëve më shumë motivohen shumica e nxënësve që të marrin pjesmarrje aktive në orën mësimore. Nxënësit dhe prindërit janë të njoftuar me standardet e vlerësimit. Shkolla ka krijuar një sistem për raportimin për prindërit për ecurinë e fëmijëve të tyre dhe zbatohet në mënyrë konsistente.

4.MBËSHTETJA E NXËNËSVE

Komisioni konstatoi se të gjitha subjektet në procesin edukativo-arsimor kontribuojnë për klimë pozitive për punë.Shkolla bën çmos që të gjithë nxënësit të ndjehen të mbrojtur,të edukohen,arsimohen dhe socializohen,me çka do të vihet themeli dhe do të jetë pjesmarrës në ndërtimin dhe formimin e personalitetit produktiv.Shkolla kujdeset për zgjedhjen e shkollimit të mëtejshëm për nxënësit që mbarojnë shkollimin nëntëvjeçar.Këtë e bën nëpërmjet bisedave,prezantimeve,broshurave dhe shkollave të msme etj nga ana e shërbimit pedagogjik.

5.ETOS (KLIMA E SHKOLLËS)

Komisioni vuri në dukje pozicionin e mëposhtëm:

Në shkollën tone klima e shkollës është në nivelin më të lartë,e ajo manifestohet nëpërmjet qasjes së drejtë dhe të njejtë ndaj gjithë nxënësit,të punësuarit dhe prindërit.Kodekset e punuara dhe rregullat e normativat e shkruara respektohen pa shmangie.Për të arritur këtë klimë pozitive ekipi udhëheqës dhe organet tjera krijojnë politikën për arritje pozitive.Puna profesionale dhe ekipore e kuadrit arsimor është tipar I veçantë që e bën çdo here shkollën të hapur për bashkëpunim në trekëndëshin arsimor(nxënës-arsimtar-prind),si dhe me kryetarin e komunës,vetëqeverisjen lokale,komuniteti I biznesit,MASH dhe BZHA.Çdo gjë do ishte më në rregull sikur të ishte kulmi I rregulluar.Shërbimi profesional nëpërmjet realizimit të aktiviteteve programore ndihmon nxënësit të mësojnë se si të njohin dhe si të merren me situata të veçanta që përfshijnë diskriminimin,duke e prërfshirë edhe avokatin e nxënësve të shkollës.Arritjet dhe rezultatet e nxënësve mbikëqyren dhe prezantohen në mënyrë të vazhdueshme dhe E-ditarin. Shkolla nuk ka probleme të mëdha me sjelljen dhe disiplinën e nxënësve.Rregullisht promovohen të arriturat e nxënësve,e nepërmjet tyre promovimi I shkollës në nivel lokal dhe më gjerë.

6. RESURSE

Komisioni vuri në dukje pozicionin e mëposhtëm:

Gjatë ekzistencës së shkollës nëpër bangat e saj kanë kaluar një numër I madh I nxënësve që si kuadro profesionale kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e komunës sonë,shtetit e më gjerë.Sot këto kuadro me sukses janë të kyçur në ndërtimin e ardhmërisë të Maqedonisë .Mësimi mbahet në shkollën qendrore dhe

periferike.Hapësira e shkollës ashtu është e rregulluar dhe organizuar që të mbahet mësimi qetë.

Shkolla përpiqet që të jetë në rrjedha me risitë në mësim prandaj vazhdimisht përcjell dhe siguron mjete të reja mësimore.Meqenëse bëhet fjalë për material harxhues dhe vazhdimisht ka novitete kur bëhet fjalë për mjetet mësimore,shkolla bën përpjekje për blerje të vazhdueshme kuptohet në konsultim me arsimtarët..

Stafi mësimdhënës është e përfaqësuar kryesisht në mënyrë profesionale si kusht për udhëzim të cilësisë. Shkolla respekton legjislacionin për zhvillim profesional të kuadrit,dhe ka edhe mekanizma të brendshme për shpërblimin e arsimtarëve të suksesshëm që sjell risi efektive në punë.

Shërbimi profesional në programin e punës planifikon dhe zbaton aktivitete të ndryshme për punë me nxënësit dhe arsimtarët dhe është e hapur për ndihmë dhe bashkëpunim.

Kulmi I shkollës urgjentisht të sanoet.

7. MENAXHIMI DHE KRIJIMI I POLITIKËS

Komisioni konstatoi këtë gjendje:

Këshilli drejtues është konstituuar në pajtueshmëri me legjislacionin dhe Statutin e shkollës.Organi drejtues me sukses pranon,kordinon dhe bashkon të gjitha aktivitetet dhe nevojat për të gjithë që janë të kyçur në punën e shkollës.Organi drejtues vazhdimisht e nxit,zhvillon dhe përcjell punën ekipore.Sjell vendime të drejta dhe përgjegjëse dhe ka marrëdhënie profesionale ndaj punës, e cila është e bazuar në aftësitë e fundit dhe ka aftësinë për të deleguar në mënyrë efektive përgjegjësitë për të komunikuar me nxënësit, stafin dhe prindërit.Shkolla nëpërmjet mbajtjes së rregullt të mbledhjeve me këshillin e prindërve,mbledhjeve prindore dhe këshillin e arsimtarëve I njofton të gjithë subjektet e interesuara për realizimin e objektivave duke marrë parasysh mendimet dhe propozimet e tyre.

Kuadri udhëheqës monitoron rregullisht përdorimin e duhur të buxhetit, në mënyrë që të marrin cilësinë e duhur për mjetet e shpenzuara.

Përparësitë e shkollës:

- 1.Rikonstruimi I kulmit të shkollës
- 2.Në shkollë veçanërisht punohet për të drejtat e fëmijëve dhe pjesmarrje aktive të tyre në jetë dhe shkollë
3. Kuadri arsimor është në hap me modernizimin në mësim me çka ritet kreativiteti dhe pasurohet proçesi mësimor.
4. Bashkëpunim I mire ndërmjet arsimtarëve,drejtorit dhe shërbimit profesional
5. Për të arriturat e nxënësve,prindërit janë rregullisht të njoftuar nepërmjet mbledhjeve prindore, E-ditari dhe bashkëpunimit në relacion me arsimtar – nxënës-prind-shërbimi pedagogjik-drejtor.
6. Plan programet në kohë dhe me cilësi të realizuara në përputhje me MASH dhe BZHA.

7. Përgatitje me kohë të planeve vjetore globale, tematike dhe planifikimet tematiko – procesuale.
 8. Ekziston punë ekipore e arsimtarëve.
 9. Arsimtarët për çdo ditë mbajnë evidencë për rregullsinë, sjelljen dhe të arriturat e fëmijëve në ditarin e klasës, E – ditarin dhe fletat evidentuese.
 10. Orientimi profesional me nxënësit e klasave IX realizohet me kohë, shqyrtohen dhe shqarohen konkurset e publikuara të shkollave të mesme dhe bëhen prezantime dhe biseda individuale.
 11. Klimë positive për punë në shkollë.
 12. Motivim i vazhdueshëm i nxënësve për arritje dhe rezultate më të mira
 13. Vijimi i rregullt i të punësuarve në vendin e punës sipas rregullave
 14. Bashkëpunim i mire me vetëqeverisjen lokale
 15. Të drejtat dhe obligimet e njëjta të nxënësve të shkollës qendrore dhe periferike.
16. Shkolla organizon dhe pergadit aktivitetete te integruara multietnike per perforcimin e vetedijes per jete te perbashket ne nje rreth multietnik.
17. I përgatitur plani – zhvillimor për vitin e ardhshëm
 Propozim masat dhe rekomandimet për zhvillim në periudhën e ardhshme
1. Zhvillim permanent profesional i kuadrit arsimor
 2. Modernizimi i mësimdhënies duke përdorur ndihmat moderne të mësimdhënies.
 3. Përdorimi i mënyrës së vlerësimit formative dhe sumativ të nxënësve
 4. Pajisja e kabineteve
 5. Edukimin e prindërve për rolin e shkollës në zhvillimin e fëmijëve të tyre.
 6. Përmirësimi i bashkëpunimit me shkollat e mesme nga komunat tjera
 7. Bashkëpunimi me prindërit e fëmijëve me sukses të dobët.
 8. Sigurimi i shpërblimeve për nxënësit që kanë sukses të shkëlqyeshëm në kontinuitet.
9. Kyçja e një numri sa më të madh të nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve në inplementimin e aktiviteteteve të integruara multietnike.
10. Drejtori dhe zëvendës drejtori më shpesh të vizitojnë orët mësimore

Nga komisioni i shkollës
 për zbatimin e Vetëevaulimin
 në SHFK “Goce Dellçev” Gostivar

- | | |
|---------------------|--|
| 1. Sahide Neziri | |
| 2. Gordana Nastoska | |
| 3. Mirushe Xhaferi | |
| 4. Goran Pavloski | |
| 5. Dragan Mateski | |